



**CIMC - 2009/02**

## **Rregullorja e KPM-së mbi Kualifikimet për dhënjën e Licencës së KPM-së për Transmetim**

### **Preambula:**

Bazuar në nenet 3.1; 3.2 dhe 3.3 të Ligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe Transmetim (Ligji i KPM-së), si dhe në bazë të nenit 4 të Politikës së Transmetimit të Komisionit të Pavarur për Media (Politikat e Transmetimit), dhe në pajtim me parimet e lirisë së shprehjes dhe praktikën më të mira evropiane, Këshilli i KPM-së miraton këtë Rregullore për kualifikimet për dhënjën e licencës për transmetim.

1. **Qëllimi:** Kjo rregullore përcakton kriteret që kërkohet të plotësojnë kandidatët për Licencë të KPM-së. Në vlerësimin e kërkesave të paraqitura për dhënien e Licencës së KPM-së do të zbatohen kriteret e parapara me nenin 12.4 të Ligjit të KPM-së dhe kriteret shtesë të përcaktuara nga Këshilli i KPM-së me rastin e shpalljeve publike për frekuenca të reja.

### **2. Kompetencat:**

2.1 Neni 2.4 i Ligjit të KPM-së përcakton që KPM-ja rregullon spektrin e frekuencave në Republikën e Kosovës si dhe licencën transmetuesit publik dhe privat për t'i përdorur ato në pajtueshmëri me politikën më të mira evropiane, duke përfshirë zbatimin e politikës së transmetimit të përcaktuar nga Këshilli i KPM-së.

2.2 Sipas nenit 11.1 të Ligjit të KPM-së për të ushtruar transmetim në Kosovë kërkohet licenca për transmetim, të cilën e lëshon Komisioni i Pavarur për Media (KPM).

3. **Politikat e Transmetimit:** Në pajtueshmëri me nenin 3.1, 3.2 dhe 3.3 të Ligjit të KPM-së, Këshilli i KPM-së ka themeluar politikën e transmetimit, bazuar në parimet e lirisë së shprehjes dhe praktikën më të mira evropiane. Në dhënien e licencave, KPM do të zbatojë politikën e transmetimit duke inkurajuar vlerat demokratike, profesionalizëm të nivelit të lartë, shumëllojshmëri mediale dhe qëndrueshmëri financiare të mediave elektronike, për të mbrojtur lirinë e të shprehurit duke siguruar transparencë të pronësisë së medias dhe të stimulojë ekonominë e tregut medial nëpërmjet rregullimit të transmetimit të komunikimeve komerciale.

**4. Zbatimi:** Kualifikimet për Licencë të KPM-së do të zbatohen për të gjitha licencat e dhëna nga KPM-ja.

**5. Përkufizimet:**

**A. Licencë:** është leje e kushtëzuar, kontraktuale e dhënë nga KPM-ja për transmetime radio-televizive. Licenca e obligon të Licencuarin që të veprojë në pajtim me Ligjin e KPM-së dhe ligjet tjera relevante të zbatueshme në Republikën e Kosovës, rregulloret dhe udhëzimet e KPM-së si dhe kushtet dhe termet e përgjithshme të Licencës së KPM-së.

**B. I Licencuari:** është subjekti të cilit i jepet një Licencë e KPM-së për të ofruar shërbime audiovizuale. I Licencuari mund të jetë:

1. Kompani private e regjistruar ligjërisht në Republikën e Kosovës, ku përfshihen por nuk kufizohet vetëm në to, ndërmarrje e biznesit privat, ortakëri e zakonshme, ortakëri e kufizuar, ndërmarrje aksionere ose me përgjegjësi të kufizuar që ka të regjistruar ushtrimin e veprimtarisë së transmetimit të programeve përmes radio apo TV;
2. Organizatë Jo Qeveritare (OJQ) e regjistruar në bazë të ligjit të aplikueshëm në Republikën e Kosovës, në veprimtaritë e së cilës përfshihet edhe transmetimi i programeve radio apo TV.

**C. Pronësi:** Zotërimi i subjektit transmetues i më shumë se 49 përqind (%) të pjesës së kapitalit bazë të një subjekti transmetues dhe/ose të pajisjeve të tij.

**D. Kandidat:** është çdo subjekt që bën kërkesë për licencë të KPM-së ose ai që kërkon miratim për transferimin e një licence ekzistuese ose miratimin për marrjen e një pjese të pronësisë tek një i licencuar ekzistues.

**E. Agjent:** është një individ që përfaqëson dhe zbaton udhëzimet e një pale të tretë, përfshirë, por jo të kufizuar me organizata politike.

**6. Kualifikimet për Licencë:** Kandidati duhet të ofrojë dëshmi dhe të garantojë me shkrim që i përmbahet këtyre kushteve:

**A. Prezencë të ligjshme në Kosovë:**

1. Kompania private ose organizata joqeveritare duhet të jenë fizikisht të pranishëm në Republikën e Kosovës dhe të jenë të regjistruar në përputhje me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës, që lidhen me to.

2. Gjithashtu, përfaqësuesi i Kompanisë ose organizatës joqeveritare duhet që, me rastin e aplikimit për licencë, të ofrojë dëshmi se është shtetas i Republikës së Kosovës.

#### **B. Kualifikimet Profesionale:**

1. Kandidati për Licencë duhet të tregojë angazhim dhe aftësi për të vënë në funksion një subjekt transmetues në përputhje të plotë me rregulloret e KPM-së duke përfshirë dhe Kodin e Sjelljes për Mediat Elektronike, kushtet dhe termet e përgjithshme të Licencës së KPM-së, standardet teknike dhe të gjitha aktet nënligjore të nxjerra nga Këshilli i KPM-së;
2. Kandidatët duhet të tregojnë angazhim dhe aftësi të sigurojnë programe komerciale në mënyrë ligjore duke respektuar Ligjin për të drejtat e Autorit dhe të drejtat e përafërta;
3. Kandidatët duhet të tregojnë angazhim dhe aftësi për të vënë në funksion një subjekt transmetues, radio apo televizion, çoftë si biznes ose si organizatë jo fitimprurëse.

#### **C. Raporti me Taksat:**

Kandidati duhet të jetë në pajtueshmëri me të gjitha ligjet për taksat në Republikën e Kosovës. Konstatimi i ndonjë shkeljeje lidhur me taksat do të shërbejë si bazë për mosdhënie të Licencës së transmetimit.

#### **D. Zbatueshmëria për Pronarët e Mediave të tjera në Republikën e Kosovës:**

Inkurajimi i shumëllojshmërisë dhe i konkurrencës në tregun e mediave në Republikën e Kosovës në shkallë lokale, rajonale dhe nacionale është politikë e KPM-së. Koncentrimi i mediave në republikën e Kosovës do të rregullohet nga KPM me një akt të veçantë nënligjor.

#### **E. Zbatueshmëria për Pronësinë e Huaj:**

Pronësia e huaj e një subjekti transmetues lejohet vetëm në rastin e kompanive komerciale me prani të regjistruar ligjërisht në Republikën e Kosovës në përputhje me Ligjin në zbatim.

#### **7. Arsyet e Skualifikimit për marrjen e Licencës:**

- A. Entitetet Qeveritare:** Është politikë e KPM-së që të mos u japë Licenca transmetimi agjensive qeveritare, ndërmarrjeve ose entiteteve të tjera në të cilat qeveria ka ndikim në kontrollin e tyre.

**B. Individë që janë të Zgjedhur ose të Emëruar në një Funkcion të lartë Zyrtar:**

- a) nuk do t'i jepet Licencë një OJQ-je, kryetari, nënkryetari ose drejtori ekzekutiv i të cilës janë të zgjedhur ose të emëruar në funksione të larta zyrtare në nivel qeveritar apo të ndonjë partie politike;
- b) nuk do t'i jepet Licencë një kompanie në të cilën pronësia e shumicës së aksioneve i përket një personi të zgjedhur ose të emëruar në funksion të lartë zyrtar qeveritar apo të ndonjë partie politike, përveç rasteve kur një person i tillë ka dhënë zyrtarisht dorëheqje nga menaxhimi i subjektit transmetues.
- c) Kjo dispozitë nuk do të zbatohet ndaj individëve të punësuar në Shërbimin Civil të Kosovës.

**C. Individët që kanë pozita drejtuese në një Parti Politike:** Dispozitat e Paragrafit 7 do të zbatohen njësoj për të gjithë individët që janë të zgjedhur ose janë të emëruar në një post drejtues brenda një partie politike. Të njëjtit nuk mund të bartin pozita udhëheqëse në strukturën organizative të kandidatit për Licencë.

**D. Organizatat dhe Kompanitë e Lidhura me Partitë Politike:** Nuk do t'i jepet Licencë një OJQ-je ose organizate komerciale që në mënyrë të hapur i kushtohet mbështetjes së një partie politike.

**E. Moszbatim i mëparshëm i rregulloreve të KPM-së:** Shkelje serioze dhe të përsëritura të rregulloreve të KPM-së nga një subjekt transmetues i cili është në pronësi, drejtohet ose financohet nga kandidati, përbënë bazë të mjaftueshme për refuzim të Licencës së KPM-së, të re ose të transferuar apo për aprovimin për marrjen e një pjese të pronësisë. Shkelje të tilla merren si fakte të dështimit të vënjes në funksion të një subjekti transmetues në pajtueshmëri me Ligjin, rregulloret dhe udhëzimet e KPM-së, përfshirë edhe të gjitha aktet tjera nënligjore të nxjerra në pajtim me Ligjin e KPM-së.

**F. Lidhja me Paragjykime Etnike ose fetare:** Nuk do t'i jepet Licencë një organizate ose ndërmarrjeje komerciale në rast se ndonjëri nga stafi udhëheqës ka qenë i lidhur me shpërndarjen e materialeve që nxisin urrejtje ose diskriminim, ose që denigrojnë persona në bazë të përkatësisë etnike, origjinës kombëtare, fesë, gjinisë, orientimit seksual ose të paaftësisë fizike.

**G. Shkeljet Penale:** nuk do t'i jepet Licencë dhe nuk do t'i lejohet marrja e një pjese të pronësisë tek një i licencuar, asnjë kompanie ose organizate jo qeveritare nëse ndonjëri nga stafi udhëheqës i tyre është shpallur fajtor për një krim të rëndë ose për vepër penale.

8. **Agjentët e të Licencuarit Potencial:** Dispozitat e kësaj rregulloreje do të zbatohen plotësisht dhe njësoj tek çdo individ, organizatë ose kompani që vepron si agjent i një të licencuari potencial.
9. **Kërkesa me Pretendime të Pavërteta:** Neglizhimi i një kandidati ose të licencuari për të zbuluar informacione që mund ta bëjnë KPM-në që të refuzojë miratimin për modifikimin ose transferimin e një licence ose të pjesës së pronësisë së një të licencuari, në bazë të kushteve të kësaj Rregulloreje mund të ketë si pasojë dënime të mëvonshme, përfshirë edhe skualifikimin për marrje të Licencës ose revokimin e Licencës së KPM-së.
10. **Ndryshim i Rrethanave të të Licencuarit:** Çdo ndryshim në gjendjen e zyrtarëve të OJQ-ve ose pronarëve të kompanive që zotërojnë Licencë të KPM-së ose një pjesë të pronësisë, që ka si pasojë skualifikimin e tyre për Licencë, duhet t'i raportohet KPM-së brenda pesë (5) ditëve pune nga ndryshimi i gjendjes. Një individ i skualifikuar mund të shkëputet vetë nga i licencuari brenda 30 ditëve nga koha kur u ka arritur në pozitë për skualifikim, përveç rastit kur KPM-ja lejon një periudhë më të gjatë për të bërë rregullimin. KPM-ja do të kërkojë në këto raste të minimizojë rrezikun e çrregullimit të operimit të subjektit transmetues.
11. **Ankesa ndaj Refuzimit:** Çdo kandidat të cilit i është refuzuar dhënja e Licencës ose aprovimi për pronësi të një pjese të licencës mund të ankohet në Bordin për Ankesa të Mediave brenda 30 ditëve nga dita e refuzimit nga ana e KPM-së.
12. **Hyrja në fuqi:** Kjo rregullore hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit.

  
Argjentina Grazhdani,  
Kryetare e Këshillit të KPM-së



Datë: 12.06.2009  
Prishtinë